

DeckDegrayer



REMOVER



Kthimi te starti: Zhbëni vjetërsimin e drurit tuaj për shkak të motit!

Pastrues special për sipërfaqe prej druri në ambiente të jashtme. Rinovimi pa smerilim! LOBA DeckDegrayer nxjerr përsëri në pah ngjyrën e natyrshme të drurit. Përdorni pastruesin special të biodegradueshëm për dyshemenë e verandës tuaj, mobiliet dhe objektet e kopshtit tuaj prej druri. Trajtimi ideal paraparak para vendosjes së LOBA DeckPrepare si dhe LOBA DeckOil / Color ose LOBA DeckFinish Color.

- Përgatitja ideale e kthimit në gri për trajtimin e mëtejshëm
- Përpunimi i shpejtë dhe i sigurt
- Mund të përdoret në sipërfaqe horizontale dhe vertikale si dhe te mobiliet e kopshtit, nuk pikon
- Smerilimi nuk është i nevojshëm
- I përdorshme për të gjitha llojet e drurëve

Gama e përdorimit:

E përshtatshme për përdorimin mbi sipërfaqet prej druri në ambientet e jashtme. Hiqni skorien e veshjes me dërrasa të lyer me vaj të tarracës. Pastroni veshjen me dërrasa të llakuar të tarracës dhe përgatiteni për llakimin e mëpasme. Hapni porët e veshjes së re me dërrasa, lani substancat përbërese të drurit nga sipërfaqja.

Të dhëna teknike të produkteve

NR. ARTIKULLI			
10741	2,5l	6	144

Vlera pH	2,7
Përbërësit	< 5% lëndë aktive anionike, METHYLCHLOROISOTHIAZOLINONE AND METHYLISOTHIAZOLINONE (3:1)
Magazinimi dhe transportimi	36 muaj kohëzgjatja maksimale e magazinimit. Material i parrezikshëm sipas ADR. Depozitim dhe transportim në temperatura +5°C deri +25°C. Mbrojeni nga ngrica.
GISCODE	GG10

Udhëzime përpunimi

TRE SEKTORË PËRDORIMI, NJË MËNYRË PROCESIMI.

heqja e ngjyrës gri nga dyshemeja e vjetër e vajosur e verandës

- Formula speciale mundëson heqjen e ngjyrës gri të drurit.

pastrimi i verandës së vjetër të llakuar dhe përgatitja për ta llakuar më pas

- Përgatitja optimale për një aftësi të sigurt ngjitje të izolimit të mëvonshëm.

verandë e sapo shtruar, hapje e poreve, larja e substancave përmbajtëse të drurit nga sipërfaqja

- Te llojet e drurëve me përmbajtje të lartë të substancave përbërëse drusore, sidomos drurët halorë dhe ato ekzotik, kanë tendencën, që ato të pasurohen në sipërfaqen e drurit, p.sh. druri tik që nuk është smeriluar direkt, ndjehet madje si i vajosur. Në mënyrë që të mund të krijohet bashkimi optimal i produkteve tona me drurin, duhet që këto substanca përbërëse të drurit, rrëshirat dhe vajrat, të lahen nga sipërfaqja. Gjatë këtij procesi hapen edhe poret e sipërfaqes së drurit dhe produktet depërtojnë më mirë.
- Tundni mirë materialin.
- Mënjaroni mundësisht përpunimin nën rrezatimin e fortë të diellit. Punoni në sektorë. Lagini më parë sipërfaqet për të siguruar, që produkti nuk thahet shumë shpejt.
- Kini parasysh rregullat e përgjithshme dhe specifike të sigurisë së punës për produktin. Me shumë informacion specifik në lidhje me GISCODE mund të gjendet tek udhëzimet e përdorimit, të disponueshme në www.wingis-online.de.

HOLLUES

Produkti është gati për përpunim dhe nuk lejohet hollimi!

MJET APLIKIMI / NORMË APLIKIMI

Furçë ose Furçë vaji LOBA / përafërsisht 150-200 ml/m² (5-6m²/l). Përcaktoni konsumimin e saktë me testim lysterje paraprake.

PËRDORIMI

- Papastërtitë e lira mund ti hiqni më parë me fshesë.
- Lageni në fillim sipërfaqen për të mënjeluar një tharje shumë të shpejtë të LOBA Degrayer.
- Aplikoni një shtresë të trashë LOBA DeckDegrayer të pa-holluar me një penel ose një furçë vaji LOBA mbi drurin që duhet pastruar.
- Lëreni materialin që të veprojë për rreth 10 minuta.
- Për përpunimin e sipërfaqes ne këshillojmë një makineri pastrimi të përshtatshme për verandat prej druri (automat thithje dje fërkimi, pastrues me presion të lartë me komponentet përkatëse,...). Si alternativë përpunojeni sipërfaqen me një furçë të ashpër pastrimi ose me një furçë normale përgjatë fibrave të drurit.
- Në fund shpëlajeni të gjithë sipërfaqen me ujë të pastër, ose spërkateni me zorrë me ujë. Në rastin e papastërtive që nuk hiqen me lehtësi, përsëriteni trajtimin, ose lëreni LOBA DeckDegrayer që të veprojë më gjatë.
- Pas tharjes, thyeni me një fshesë çeliku ose makineri smeriluese dhe LOBASAND SuperPadgrün fibrat e drurit që mund të jenë ngritur për të arritur sipërfaqe më të lëmuara. Vajiseni më pas LOBA DeckOil ose vendosni një shtresë LOBA DeckPrepare dhe LOBA DeckFinish, në përputhje me informacionin teknik mbi produktit.

Udhëzime të përgjithshme

Pastrimi i mjeteve të punës: Pastroni mjetet e punës me ujë menjëherë pas përdorimit.

Informacioni në këtë material si dhe të gjitha këshillat dhe rekomandimet, të cilat ofrojmë në ndihmë dhe asistencë të përdoruesit, janë rezultat i përvojës së deritanishme dhe u referohen kushteve Speciale. Për shkak të mundësive të shumta të aplikimit dhe kushteve të përpunimit, nuk përjashtojmë nevojën e përdoruesit për të kryer testimet e veta ose të kërkojë këshilla teknike duke kontaktuar me Departamentin e aplikimit teknik LOBA. Respektoni standartet aktuale dhe rekomandimet e prodhuesit të produkteve për shtrimin-përpunimin e parketeve. Detyrimet dhe përgjegjësia jonë përcaktohet ekskluzivisht nga Termat dhe Kushtet tona dhe nuk zgjerohen as përmes këtij informacioni as përmes këshillave tona. Publikimi i të dhënave më të reja teknike automatikisht zhvlerëson ato të mëparshme.

Koha e tharjes: Kohët e dhëna të tharjes vlejnjë në +20°C dhe në 50% lagështirë ajri relative. Temperaturat më të ulëta, lagështia relative më e lartë e ajrit shkakton vonesa të tharjes. Para arritjes së fortësisë finale mos pastroni me leckë të lagur. Karakteristikat specifike të produktit gjenden në informacionet teknike përkatëse.

Fjalët dhe simbolet me shenjën ® përfaqësojnë të drejta tregu, të cilat janë të regjistruara dhe të mbrojtura të paktën për hapësirën e Gjermanisë.